

KARAKTERISTIKAT E POSTMODERNIES / POSTMODERNIZMIT CHARACTERISTICS OF POSTMODERN / POSTMODERNISM

MIRLINDA KRIFCA-BEQIRI

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski", Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi" - Shkup

Email: mirlindakrifca@yahoo.com

AKTET VI, 5: 537-546, 2013

PËRMBLEDHJE

Ky punim teorik synon t'i paraqesë karakteristikat kryesore të postmodernies/ postmodernizmit. Pavarësisht dallimeve që ekzistojnë mes studiuesve të ndryshëm, megjithatë të gjithë men-doj-në se karakteristikat më të rëndësishme të këtij formacioni stilistik, që paraqesin ideogra-min poetik të postmodernies janë:

1. Intermedialiteti - zhvendosja zhanrore, dukuri kjo, me të cilën thehen konventat e vjetra zhanrore dhe krijohen vepra që për nga struktura e tyre janë hibride, meszhanrore ose bizhanrore.
2. Metafikcioni - krijimtaria letrare në mënyrë të vetëdijshme e kthen vëmendjen në statusin e saj të artefaktit me qëllim që të parashtrijë pyetje për lidhjen mes prozës dhe realitetit, prandaj bëhet një përzierje mes komentit kritik dhe tekstit letrar.
3. Qëndrimi mohues ndaj metanarracioneve, që mundësoi masovitetin e lëvizjeve të ndryshme (si: feminizmit, postkolonializmit etj), gjëgjësisht lëvizjeve që karakterizohen me "vetëdijen e tyre të dyfishtë".
4. Qëndrimi ndaj historisë - për dallim nga moderia, postmodernia mendon se e kaluara nuk duhet dhe nuk mund të mohohet, por duhet në mënyrë ironike të rivlerësohet. Ajo ka qëndrim ironik ndaj historisë oficiale dhe kërkon që të "oficializohet" historia jooficiale.
5. Intertekstualiteti – nëpërmjet të procedesë së konstruksionit dhe dekonstruksionit shumë tekste të vjetra, që gërshetohen në tekstin e ri post-modern, funksionojnë si tekste të reja. Në çdo vepër të re hetohet zëri i veprave paraprake. Veprat postmoderne janë vepra të koduara dialogjike, ku vërehen gjurmë nga tekste tjera ose kontekste.
6. Fragmentarizmi – një nga format kanonike të postmodernies, që paraqet edhe dukurinë e humbjes së pozitave stabile mes qendrës dhe periferisë. Ngjarja në këto realizime artistike është fragmen-tare.

Fjalet kyçe : postmodernia, intertekstualiteti, intermedialiteti, metafikcioni, fragmentarizmi

SUMMARY

This theoretical paper has an intention of presenting main characteristics of the postmodern/ postmodernism. Regardless the existing distinctions among the different scholars all of them believe that the most important characteristic of this stylistic formation, which represent the poetic ideogram of postmodern, are:

1. Intermediality – genre displacement; a phenomenon that breaks old genre conventions and creates works that by its structures are hybrid, inter-genre and sub-genre.
2. Meta-fiction – literature work which in a very aware way return the attention in its artifact status in order to ask a question related to the relation between prose and reality, therefore it becomes a mixture of critic comment and literature text.
3. The non accepting attitude toward meta-narrations, which enabled the increasing of different movements (such as: feminism, post-colonialism etc.), i.e. movements that are characterized by "their dual awareness".

4. The attitude towards the history – contrary to modern, postmodern believes that the past should not and cannot be neglected, but it should be re-evaluated in an ironic way. It has an ironic attitude towards official history and requires to “making official” the unofficial history.

5. Intertextuality – through the procedure of construction and deconstruction of lots of old texts, which interact in the new postmodern text, functioning as old texts. In every new work remains the voice of the previous work. Postmodern works are dialogue coded papers where can be viewed traces from other texts or contexts.

6. Fragmentation – one of the canonic forms of postmodern, which represents the phenomena of losing stable positions between center and peripheries. The event in these artistic work is fragmented.

Key words: postmodern, intertextuality, intermediality, metafiksioni, fragmentation

Hyrje

Studiues të ndryshme flasin për karakteristika të ndryshme të postmodernies. Megjithatë, mund të pranohet mendimi se karakteristikat më të rëndësishme të postmodernies janë: intermedialiteti (thyerja e kufijve zhanror - përzihet drama dhe tregimi, letërsia dhe piktura, letërsia dhe gazetaria etj.); pasticio – tekst i krijuar sipas rregullave të ndonjë teksti tjetër, kështu krijohen imitimet; intertekstualiteti – dialogu dhe gërshetimi i tekstit me tekste të tjera dhe atë jo vetëm letrare, apo dialogu me ndonjë mit, legjendë, kod ose me kontekstin; metafiksioni-letërsia më tepër se fiksjon për botën fiktive flet për vete, për problemet e shkrimit; deqendërimi – humbet raporti qendër – periferi, domethënë nuk ka temë qendrore të rrëfimit; fragmentarizmi – teksti është fragmentar, në të shfrytëzohen citate nga tekste të ndryshme; ironizimi; karnevalizmi etj. Postmodernia karakterizohet, gjithashtu, me teknikat e saj dhe me temat e saj karakteristike.

Llojlojshmëria dhe paradoksalja magjepsin postmodernien. Ajo nuk mëton ndonjë vision total. Ajo vetëm parashtron pyetje. Detronizimi i absolutes, vënia në dyshim e realitetit, e të vërtetës, e dominimit të arsyes, gjithashtu, janë karakteristika të postmodernies.

Në vend të kontinuitetit modern të tekstit letrar, paraqitet diskontinuiteti postmodern, që dëshmohet nëpërmjet paragrafeve, shpesh të shkurta dhe të palidhura, hapësirave të zbraza.

Në postmodernie vrojtohen vepra me karakter autoreferencial dhe autopoeitik, që karakterizohen me një kthim dhe mbyllje, që interpretohet si parashikim konstituiv për hapjen e saj në qasje dhe rrëfim. Shumica e romaneve

moderniste karakterizohen me “mbyllje, fund të hapur”. Postmodernistët, nga ana tjetër, në pjesën më të madhe të rasteve, i mbarojnë romanet e tyre me më shumë mbyllje parodizuese, shumicën prej të cilave vetë lexuesit do ta interpretojnë sipas dëshirës së tij.

Në postmodernie, autori dhe teksti e humbin kuptimin që kanë pasur dikur dhe lexuesi fiton status të ri. Postmodernistët mëtojnë një bashkëveprim më të theksuar mes autorit dhe lexuesit, për dallin nga pararendësit e tyre, që glorifikonin rolin e autorit dhe minimizonin atë të lexuesit. “*Të theksosh se natyra e letërsisë dhe e historisë është patjetër tekstuale dhe intertekstuale, nuk do të thotë ta përjashtosh prodhuesin: kjo nuk e ndërron statusin dhe rolin e tij*” (Haçion, *Diskursi, forca, ideologjia*, 284). Ekzistojnë, madje edhe teori më ekstreme, si ajo e R. Barthes-it dhe e M. Fuko-së, që e mposhtin idenë e vjetër për autorësinë.

Qendrimi ndaj historisë

Pikërisht në qëndrimin ndaj historisë, shumë studiues e kërkojnë dallimin kryesor mes modernies dhe postmodernies. Modernia ka qëndrim negativ ndaj të kaluarës, ajo e shfrytëzon atë vetëm si opozitë, kurse postmodernia nisat nga bindja se e kaluara nuk mund dhe nuk duhet të shlyhet, meqë vetëdija e postmodernies është vetëdije e prezencës së të kaluarës në të tashmen. “*Post-modernia i përgjigjet modernes duke kuptuar se e shkuara, meqë nuk mund të shkatërrohet, sepse shkatërrimi i saj shpie në heshtje, duhet të rivizitohet: por me ironi e jo në mënyrë të pafajshme . . .*” (Eko, *Emri i trandafilin*, 473).

Një nga pyetjet më të shpeshta që parashtrojnë teoreticienët e postmodernies është: në aspektin tematik, postmodernia a ka pastruar me historinë ose lidhet me të? Gjithsesi, postmodernia nuk i shmanget historisë, por mënyra e qasjes ndryshon nga ajo e modernies.

Ajo që është e rëndësishme është se postmodernia nuk ndërpret me të kaluarën historike, d.m.th bëhet fjalë për një model të ri të historicizmit, që shpesh karakterizohet me një qëndrim ironik ndaj historisë oficiale, meqë besohet se historia nuk ju takon vetëm komandantëve, andaj i kushtohet kujdes dhe *oficializohet* historia jooficiale. Postmodernia bën thirrje për t'i rishqyrtuar dhe për t'i kritikuar konceptet tona mbi historinë. *"Ajo të kaluarën e saj e inkorporon përbrenda murit të saj dhe në mënyrë parodike përpiqet të shënojë kritikën që i bën kësaj të kaluarë"* (Haçion 2004, 1 – 2: 41-42).

Në letërsinë postmoderniste, intertekstet e historisë dhe ata të fiksonit, siç shprehet L. Haçion marrin status paralel. Sipas saj: *"Ta parodizosh të kaluarën, nuk do të thotë ta zhbësh atë; në të vërtetë, përkundrazi, kjo do të thotë ta bësh të kaluarën të shenjtë, por edhe ta kontestosh atë. Ky është edhe një paradoks postmodern"* (Haçion 2004: 12).

Është thënë se shkrimi i historisë është akt fikcional. Lidhja ontologjike ndërmjet të kaluarës historike dhe letërsisë nuk është fshirë, përkundrazi është spikatur. E kaluara me të vërtetë ekziston, por ne atë mund ta njohim vetëm nëpërmjet të teksteve të saj (Haçion 2004: 13).

Postmodernia nuk është plotësisht avangarde, meqë ajo nuk është gjithaq mohim (i të kaluarës) ose utopi (e të ardhmes) sa është avangarda. Ajo, në brendinë e saj, e inkorporon të kaluarën dhe në mënyrë parodiake mundohet të shënojë kritikën që i bën kësaj të kaluarë.

Sipas historianit Lakapri: *"e kaluara arrin te ne në formë tekstesh dhe mbetjesh të tekstualizuara kujtime, korrespondencash, veprash të botuara, arkivash përmendoresh etj"* (Haçion 2004: 13).

Sipas L. Haçion, kjo nuk do të thotë mohim i teksteve historike.

Pra, postmodernia, duke shkapërderdhur qendrën, mundëson që marginat dhe skajet, madje edhe në interpretimin e ngjarjeve historike, të marrin një vlerë të re. Eks - centrikja dhe jashtë - centrikja tërheqin vëmendjen e autorëve të metafiksonit historiografik. Posmodernizmi i konteston, por nuk i rrënon sistemet qendëruese, totalizuese, hierarkike, të mbyllura.

Autorët e postmodernies kënaqen duke ripunuar stile dhe forma të vjetra letrare dhe artistike, duke mos dashur të shkëputen plotësisht nga tradita (sikurse p.sh autorët e modernies).

Arti postmodern mbështetet në *"tashmë të treguarën"*. Historia në postmodernizëm e humb kuptimin, që ka pasur deri atëherë. Historia dhe historikja kuptohen në kuptimin e bindjeve të *Karl Poperit* mbi pamundësinë e vërtetimit të të dhënave shkencore dhe njohjen e tërësishme të botës.

Për dallim nga mbyllja formale moderniste, fiksoni postmodern ka qëndrim të hapur ndaj historisë, ose ndaj asaj që shumica e quajnë *"botë"*. Vepra letrare karakterizohet me intertekste të historisë dhe të fiksonit. Postmodernistët janë të vetëdijshëm se paraqitja e realitetit nuk është njëlloj sikurse vetë realiteti. Sipas J. Kristevës, kjo *"botë"* është e lidhur drejtpërdrejtë me botën e njëmendësisë empirike, por nuk është vetvetiu pikërisht bota e vërtetë e realitetit empirik.

Patrisha Vo, duke u ndalur në vepra të caktuara postmoderniste, vjen në përfundim se jo vetëm që është akt fikcional shkrimi i historisë, por se edhe vetë historia, sikurse fiksoni, është e prirë drejt gërshetimeve të lidhura mes veti. Kështu që lidhja e njohur ontologjike mes historisë dhe letërsisë spikatet edhe më tepër në këtë periudhë.

Teoria postmoderniste pranon statusin shoqëror të artit. Në diskutimet për postmodernizmin nuk anshkalohet praktika shoqërore, kushtet historike të kuptimit dhe rrethanat, në të cilat krijohen dhe pranohen tekstet.

Teksti pjesë e një zinxhiri midis teksteve t[tjera

Një nga karakteristikat më të rëndësishme të postmodernies është fenomeni i intertekstualitetit, që paraqet dialogun tekst - tekst ose tekst - kontekst. Sipas manifestit të Xhon Bart, intertekstualiteti paraqet veçorinë kryesore të poetikës së postmodernies. Intertekstualiteti paraqitet si ideogram i ri, i cili mundëson që letërsia të largohet prej formave, tanimë të konsumuara dhe të sjell[forma të reja. Nëpërmjet të procedesë së konstruksionit dhe dekonstruksionit, shumë tekste të vjetra që gërshetohen në tekstin e ri postmodern funksionojnë si tekste të reja.

Julia Kristeva e përdor[për herë të parë nocionin *intertekstualitet* në veprën e saj *“Semiotika”* (1969). Megjithatë, studimet që kanë të bëjnë me intertekstualitetin si parametër teorik dhe letrar duhet të kthehen në vitet `20 të shek. XX, gjegjësisht me studimet e Mihail Bahtinit dhe veprës së tij *Probleme t[poetikës së Dostoevskit* (1929).

Në të vërtetë, për shenjimin e kësaj dukurie, Bahtin përdor nocionet: *dialog*, *dialogëzim*, *shumzëshmëri*, *polifoni*. Vet[Kristeva pranon se: *“atëherë nocioni i intertekstualitetit akoma nuk figuronte aq në veprën e Bahtinit, por unë mendoj se mund të konsiderohet si rezultat i veprës së tij”* (Kristeva 1996: 189).

Çdo tekst kuptimin e vet e merr vetëm si pjesë e një zinxhiri të tërë tekstesh, gjegjësisht si pjesë e diskurseve të mëparme. Roland Bart e pat definuar intertekstin si *pamundësi për të bërë jetë jashtë tekstit të pafund* (1975). Intertekstualiteti është një dukuri imanente letrare, pavarësisht se studimet mbi të lidhen, kryesisht, me postmodernien. Kopjet, intertekstet, paroditë – janë tema që kanë sfiduar konceptin mbi origjinalitetin dhe universalitetin.

Sipas M. Fuko *“Kufinj të e ndonjë libri kurrë nuk janë tërhequr (vendosur) në mënyrë të qartë, jashtë titullit, rreshtit të parë dhe pikës fundore, jashtë konfigurimeve të brendshme dhe formës autonome të tij, përmes sistemit të referencës, libri është thurje me libra të tjerë, në tekste të tjera, në fjali të tjera: ai është një përbrenda rretit”* (Haçion 2004: 12).

Intertekstualiteti paraqet raport aktiv mes tekstit dhe sistemit. Në këtë raport aktiv, autori i ri është ai që materialin e marrë nga veprat paraprake e aktualizon, e freskon, e risemantizon, e shpreh me zërin e vet. Në këtë kontekst edhe thënia e Paskalit: *“askush të mos më thotë se nuk kam thënë asgjë të re: radhitja e materialit është e re”* (Zhenet 1985: 136).

Në çdo vepër hetohet zëri i veprave paraprake, shpesh i përzier me zëra të tjerë. Andaj teoria e intertekstualitetit, nisët nga bindja se teksti është polivalent dhe se *“çdo vepër letrare krijohet përballë dhe kundrejt ndonjë modeli”* (Todorov, Poetika).

Me intertekstualitetin është e lidhur edhe ideja për *“vdekjen e autorit”*, që u bë e njohur veçmas pas studimeve të teoreticientëve R. Bart dhe M. Fuko. Intertekstualiteti, gjegjësisht raporti që teksti i ri vendos me tekste të tjera, vë në pikpyetje autorësinë duke thyer kështu iluzionin referencial dhe idenë mbi veprën autonome dhe origjinale. Tekstet e postmodernies janë tekste të koduara dialogjike, tekste në të cilat hetohen gjurmë nga tekste t[tjera, tekste në të cil[gjenden citate dhe kode, që kanë burime të ndryshme, të cilat me më shumë ose me më pak sukses do të inkorporohen në tekstin e ri, por gjithsesi pa harruar burimin e tyre, i cili hetohet m[lehtë ose më vështirë (qofshin ato burime margjinale, qofshin tekste kanonike me vlera të verifikuara). Fundja, kjo është një nga karakteristikat kryesore të prozës postmoderniste, e cila duke i fshirë kufinj të diskurseve të ndryshme, bën edhe kombinimin kreativ të elementeve nga burime të ndryshme.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të raporteve intertekstuale, disa prej të cilave janë më implicite e disa më eksplicite. Kështu dallojmë: *parodinë*, *anagramin*, *reminishencën*, *aluzionin*, *dialogun*, *alegorinë*, *përshtatjen*, *imitimin* etj.

Një nga llojet e raporteve intertekstuale është edhe aluzioni, ku materiali i huaj nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me tekstin e ri, andaj lidhja intertekstuale është implicite. Pra, te aluzioni nuk ekziston ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë, gjegjësisht nuk ekziston një tekst, që është i përbashkët për të dy tekstet (si p.sh te citati).

Në rastin e parodisë apo stilizimit, teksti i huaj është integruar në tekstin e ri. Sipas L. Haçion, parodia është një nga strategjitë subversive të postmodernizmit (Haçion 1996: 378). Implikimet kundërthënëse ideologjike të parodisë e bëjnë atë model të përshtatshëm të kritikës për postmodernizmin, i cili me rivendosjen e kovencave e pastaj me kontestimin e tyre del tejet paradoksal. *“Edhe pse për mendimin tim përkufizimi i postmodernies është diçka e ngushtë, koncepti mbi parodinë si hapje e jo mbyllje e tekstit, ka rëndësi: midis shumë gjërash që i konteston intertekstualiteti postmodern, është edhe kuptimi i mbyllur, i veçantë dhe i qendëruar”* (Haçion 2004: 12).

Në rastin e reminishencës dhe toposeve, teksti i vjetër pjesërisht lidhet me tekstin e ri. Kthimi në reminishencë, nëpërmjet të kujtesës, është një nga format e shpeshta të dialogut letrar bashkëkohor. Reminishenca shprehet nëpërmjet të citatit, nëpërmjet të mbështetjes në ndonjë procedë të caktuar artistik, në ndonjë motiv ose mendim të njohur të ndonjë personaliteti letrar. Pos citatit, edhe motoja paraqet një lloj të reminishencës, që përdoret shpesh dhe që paraqet raport të drejtpërdrejtë me një vepër ose autor të caktuar.

Citati, paraqet një nga mënyrat më të drejtpërdrejta të vendosjes së raportit intertekstual mes hipertekstit dhe hipotekstit, meqë këtu gjithmonë ekziston teksti i huaj eksplicit, që inkuadrohet në tekstin e ri. Letërsia që prej kohrave të hershme ka mëtuar të përsëritet dhe kjo dukuri, sigurisht, nuk është rastësi, meqë përsëritja mundëson që më mirë të kuptohet teksti. Prandaj, mund të konkludojmë se pavarësisht se citimi është dukuri e vjetër sa edhe letërsia, nocioni *“citatshmëri”* është i ri dhe kryesisht, lidhet me postmodernizmin.

Interteksti

Përzierja e komentit kritik me tekstin letrar është ndoshta një nga karakteristikat më të veçanta të postmodernies. Prandaj proza e shumë prozaistëve të mëdhenj postmodern, me të drejtë, është quajtur meta – prozë. Pra, nuk është e rastit që R. Bart e Zh. Derida do të konsi-

derohen edhe shkrimtarë edhe teoreticientë, meqë tekstet e tyre janë tekste kundërthënëse, thjesht postmoderniste. Metafikcioni i hulmton kufinj të mes fikcionit dhe kritikës, kufij këto që, gjithnjë e më tepër afrohen dhe faktikisht edhe asimilohen.

Fakt është se, viteve të fundit, romancierët, gjithnjë e më tepër, bëhen të vetëdijshëm për çështjet teorike, që kanë të bëjnë me konstruksionin e prozës. *“Ajo që i lidh të gjithë autorët që, përndryshe janë të ndryshëm, që në mënyrë të përgjithshme do të mund të quhen “meta - prozaist”, është ajo se të gjithë ata e studiojnë teorinë e prozës, nëpërmjet të praktikës së shkrimit të prozës”* (Waugh 1984: 173).

Sipas Patrisha Vo: *“Metafikcioni është nocion, me të cilin shenjohet krijimtaria prozaike që në mënyrë të vetëdijshme dhe sistematike e kthen vëmendjen drejt statusit të artefaktit, me qëllim që të parashtrroj pyetje për lidhjen mes prozës dhe realitetit”* (Waugh 1984: 173). Ajo mendon se metafikcioni është veçori e prozës pas realizmit, meqë proza e realizmit nuk karakterizohet me shumë zërash. Por, në mesin e studiuesve ekzistojnë edhe mendime se metafikcioni është veçori e secilës letërsi, domethënë është veçori letrare që, sikurse edhe intertekstualiteti, është shumë e vjetër, pavarësisht se ka filluar të studiohet vonë.

Shpesh teoreticientët e identifikojnë nocioni *“metafikcion”* me nocionin *“autoreferencë”*. Megjithatë, mes këtyre nocioneve, siç shprehet Linda Haçion (*Poetika e postmodernizmit*), ekzistojnë dallime, meqë nocioni letërsi autoreferente përfshin një fushë më të ngushtë teorike dhe përdoret për të përcaktuar veçoritë postmoderniste të letërsisë për tu vetëkomentuar, kurse metafikcioni është veçori e letërsisë së të gjitha kohërave. Autoreferenca është njësi e tekstit, që vendos relacion me tekstin e njëjtë, për dallim nga citati, ku relacioni vendoset me një tekst tjetër.

Kur studiohet meta – proza, në të vërtetë, studiohet ajo që ia jep identitetin romanit si zhanr letrar, që karakterizohet me një *“jostabilitet”* të dukshëm. Ky jostabilitet lidhet me faktin se romani ndërtohet nëpërmjet asimilimit të

formave të përditshme të komunikimit. Në të gjejmë elemente nga gjuha e gazetarisë, zhurnalëve, ditarëve, regjistrave të ndryshëm, shënimeve juridike. Bahtini këtë dukuri, gjegjësisht, mungesën e gjuhës së privilegjuar të romanit, e konsideron si potencial “*dialogjik*” të tij, meqë këtu gjuha e fiksonit vendos lidhje me format e tjera të diskursit, duke u bërë dialogjike. Romani thith shumësi të diskurseve. Ajo që është karakteristikë e metaprozës është që të krijohet proza dhe, njëkohësisht, të flitet për kreacionin e asaj proze. Pikërisht kjo gjë e shpëtoi romanin pas krizës së paraqitur në periudhën pas realizmit.

Hapja e romanit i mundësoi atij që të përshtatet në kushtet e reja të krijuara. Por, sido që të jetë, mungesa e një identiteti fiks e bëri romanin mjaft të kritikuar. Të vetëdijshëm për këtë gjë, metaprozai tët e kanë ndërjerë nëvojën që romani ta teoretizojë veten. Vetëm kështu, në një mjedis ku kritikohet shumë, ai do të mund të vendos[identitet.

Proza e shkruar me vetëdije ose meta - proza është emërtuar edhe si “*roman introvert*”, “*anti-roman*”, “*irealizëm*” “*mbi-prozë*”, “*roman i vetlindur*”, “*fabullacion*”. Këto emërtime të ndryshme, e vendosin theksin në drejtime të ndryshme. Nocioni “*meta – prozë*” është nocion i gjërë dhe elastik, që në vete përfshin një spektër të gjerë të prozës.

Pas realizmit edhe te romansierët edhe te kritika u krijua një paranojë – një frikë se largimi nga realizmi domethënë edhe krizë të romanit. Pikërisht kjo frikë nxiti hapjen e shtigjeve të reja në krijimtarinë prozaikë të viteve `60 -`70. Meta – proza nuk i braktis konvencat e realizmit, nuk e braktis “*botën reale*” për shkak të imagjinatës. Ajo vetëm bën rishqyrtim të konvencave të realizmit, me qëllim të vet[bulimit dhe me atë që tregon se si fiksoni letrar i krijon botërat e veta imaginative. Meta – prozaisti është i vetëdijshëm se nëse mundohet ta *paraqesë* botën, shpejt do të kuptojë se bota, si e tillë, nuk mund të paraqitet. Në prozë, është e mundur të *paraqiten* diskurset për atë botë.

Hiperteksti

Nocioni “*hipertekst*”, në letërsi ka depërtuar nga shkencat kompjuterike, ku lehtë vërehet dallimi mes tekstit të thjeshtë dhe hipertekstit, meqë teksti i thjeshtë është linear, kurse hiperteksti nuk është linear, por është objekt i përbërë prej më tepër teksteve, që janë të lidhura në më tepër nivele. Në këto media, pikërisht hiperteksti mundëson që të gjitha informacionet të jenë të kapshme, por edhe të vendosura nëpër nivele të ndryshme, sipas rëndësisë. Teksti, nga ana tjetër, nuk posedon një mundësi të tillë, sado që tenton të arrijë këtë veçori, nëpërmjet të përdorimit të fusnotave.

Nocionin “*hipertekst*” për herë të parë e ka përdorur Teodor H. Nelson në vitet `60 në fushën e shkencave elektronike dhe informative.

Zh. Zhenet në “*Palimpsest*” (Zhenet 2003: 63-75) ndalet në fenomenin e hipertekstualitetit dhe shpjegon se me të nënkupton raportin që ofron një tekst B (që do ta quajë hipertekst) me një tekst paraprak A (që do ta quajë hipotekst). Raporti i hipertekstualitetit vjen në shprehje, atëherë kur teksti B vendos ç`farëdo lidhje ose mbështetet, në mënyra të ndryshme, në tekstin A.

Rolan Bart (Bart 1979) jep një koment të mirë për hipertekstin, duke e definuar si tekstualitet ideal. Sipas tij, teksti ideal është i komponuar prej blloqeve dhe fotografive të lidhura nëpërmjet shumë rrugëve, kanaleve ose nyjeve me fund të hapur. Me këtë tekst absolutisht plural zotëron një sistem i tërë i domethënies, kuptimeve dhe numri i tyre, asnjëherë, nuk është i kufizuar.

Një mendim të ngjashëm pranon edhe Mishell Fuko në *Arkeologjinë e domethënies*, ku shprehet se një nga manifestimet e mundshme të hipertekstit është, thënë teknikisht, fusnota. Hiperteksti është, në të vërtetë, një lloj fusnote e “*pamarkuar*”. Nëpërmjet të njësisë hipertekst postmodernia vendos lidhje me letërsinë e kohërave të kaluara, por edhe me të kaluarën, që paraqet një përbërës të rëndësishëm të poetikës së saj.

Ka intenca që hiperteksti të kuptohet si realizim i utopisë së Bartit për “*vdekjen e autorit*”, gjegjësisht për shkrim të çliruar nga autori.

Xhorxh Landov (Landrow, History of the . . .), mendon se hiperteksti i megjullon kufijtë mes lexuesit dhe shkrimtarit dhe kështu instalon një cilësi plotësuese “*tekstin ideal*” të R. Bartit.

Hiperteksti dallon nga citati, pavarësisht se edhe njëri edhe tjetri mbështeten në një tekst të dytë. Hiperteksti ka pozitë të kundërt ndaj tekstit të dytë (në të cilin mbështetet), në raport me citatin. Për dallim prej citatit, i cili mbështetet në një tekst të dytë stabil, të caktuar; teksti i dytë në të cilin mbështetet hiperteksti, shpesh, është variabil, meqë ai nuk është marrë nga një tekst, por nga më shumë tekste, që i referohen asaj dukurie ose atij heroi. Për dallim nga hiperteksti, teksti nga i cili merret citati është gjithmonë po i njëjti tekst. Prandaj thuhet se në raportin ndaj tekstit të dytë, natyra e hipertekstit është e kundërt nga natyra e citatit.

Hiperteksti paraqet një mundësi për lëvizje nëpër tekst, për një tregim jolinear, duke zbutur kufinj të mes lexuesit dhe shkrimtarit.

Fragmentarizimi

Fragmentarizimi është një nga format kanonike të postmodernies. Me siguri, përdorimi i dendur i tij në postmodernizëm lidhet edhe me bindjen se njeriu bashkëkohor ka një mënyrë jo të plotë, fragmentare të vrojtimit të botës. Termi fragment, fragmentarizëm është ngushtë i lidhur me termin “*different*” (dallim) të Zhak Deridasë. Derida mendon se edhe në shkrim, ashtu si edhe në gjuhë dhe diskurs, ekzistojnë dallime mes elementeve. Sipas tij *teksti paraqet dallim të gjurmëve të teksteve tjera që veprojnë në të*. Ai mendon se sistemi, gjithmonë, ka ndonjë mangësi, diçka që i mungon dhe e bën të jetë “*jo i tërë*”. Këtë mendim e përqafton edhe Bodrijar, i cili fragmentarizmin e kupton si “*lojë më copëzat, me pjesët*”.

Edhe J. Kristeva, ndalet në çështjen e fragmentarizmit dhe humbjes së pozitave stabile mes qendrës dhe periferisë, duke u shprehur: “*Linja narrative është një membramë e hollë, e cila çdo cast mund të shpërthejë. Në të vërtetë, kur njëkohësia për të cilën rrëfëhet bëhet e padurueshme, kur shkatërrohet kufiri mes subjektit / objektit, madje edhe kufiri mes brenda dhe jashtë bëhet i padurueshëm, së pari vihet në pyetje*

çështja e rrëfimit. Nëse, megjithatë vazhdohet (me rrëfimin), atij i ndryshohet materiali: lineariteti i rrëfimit thehet dhe më tej rrëfimi realizohet nëpërmjet të pjesëve, copëzave, enigmave, shkurtesave, mungesave, të pakryerave . . .” (Kristeva 1989: 169).

Në veprat e postmodernies rrëfimi, shpesh, është, në të vërtetë, vetëm skicë e rrëfimit. Skica e tillë, i mundëson lexuesit që të njihet me *laboratorin krijues të autorit*.

Veprat e postmodernies, duke filluar nga letërsia deri te filmi, karakterizohen me fragmente të hororit, misterisë, fantastikës shkencore, përrallës, mitit, legjendës, reklamave. Ngjarja në këto realizime, qofshin letrare apo filmike, është e ndërprerë, fragmentare.

Deqend[rzimi

Një nga karakteristikat e rëndësishme të postmodernizmit është masoviteti i mjaft lëvizjeve të ndryshme (postkolonializmit, feminizmit) në kohën e tij. Asyeja qëndron në atë se postmodernizmi mundohet të flak[opozicionet binare të “*tjetrit*” (opozicionin e gjinisë, racës, klasës). Postmodernizmi përpiqet ta mposhtë hapësirën mes qendrës dhe margjinave, duke pranuar dallimin dhe sfidimin e çdo kulture.

Lëvizjet, që karakterizohen me “*vetëdijen e tyre të dyfishtë*”, ndikojnë në postmodernizmin, dhe është pikërisht *dyzëshi* ose *shumëzëshi* i tyre ai që përfaqëson njërin nga manifestimet e këtij ndikimi. Pikërisht pluralizmi postmodernist, ka krijuar hapësirë për ndikime të tilla të këtyre teorive, të cilat pikërisht në kohën e postmodernizmit morën hov të madh. “*Kritika postmoderniste e ekzistencializmit, universalizmit dhe identitetit të padeterminuar statik mund të jetë e dobishme për studimin e sërishëm të racës, por edhe të gjinisë*” (cit. nga Djurič, 1).

Duke u marrë me aspektin kritik feminist, studimet postmoderniste shpien drejt një vrojtimi të ri politik në vet[postmodernizmin, meqë feminizmi nuk është vetëm teori ose estetikë, por edhe politikë. Postmodernizmi mohon stabilitetin e pozitës së sunduesit. Ai, ashtu si edhe feminizmi apo postkolonializmi,

tenton ta afirmojë idenë e dependencës, duke u munduar të pranohen dallimet.

Zhvendosja zhanrore

Zgjerimi i kufinjve të letërsisë, nëpërmjet të ndryshimit të statusit të saj zhanror në raport me sistemin e zakonshëm zhanror, është një karakteristikë shumë e rëndësishme e artit postmodern. Shpesh vjen deri te përzierja zhanrore ose deri të fshehja e një zhanri pas karakteristikave të një zhanri tjetër, ose deri te fenomeni i quajtur *zhvendosje zhanrore*. Krijohen vepra, ku gërshetohen elemente të ditarit, letrave elektronike, shkrimeve gazetareske, recensioneve, eseve, kritikave, reklamave, komenteve etj. Fenomeni i intertekstualitetit dhe intermedialitetit janë karakteristika të rëndësishme postmoderne. Teksti i ri postmodern, gërshetohet shumë tekste tjera, të cilat funksionojnë si tekste të reja.

Loja në postmodernizëm nuk vrottohet vetëm në kombinimin kreativ të elementeve të huazuara nga burime të ndryshme, qofshin ato letrare apo jo, por edhe në qëndrimin postmodern ndaj tërë traditës letrare, qoftë ajo gojore ose artistike. Nëpërmjet të procedeve të parodisë, rrëfimit ironik, metafiksionit, detronizohen vlerat oficiale, transformohen modelet prozaike realiste ose moderne, çdo gjë. Loja në veprat postmoderniste, në të vërtetë, prodhon hipersemantikë, që interpretohet si kuptim i humbur.

Për dallim prej autorëve të modernies, që besonin shumë në fuqinë e artit të tyre dhe në atë se ai do të ndikojë në ndryshimin e botës, krijuesit postmodern, shpesh, artin e trajtojnë si lojë ose si diçka të parëndësishme në mesin armiqësor të represionit shoqëror dhe t[shkatërrimit total fizik. Domethënë, në postmodernie është mjaft i pranishëm trendi deziluzionist. Por përveç këtij trendi deziluzionist, në letërsinë postmoderniste, paraqitet edhe një rrymë e fortë e qasjes optimiste, jo më pak e komplikuar e tekstit letrar. Afrimi i tyre drejt asaj që është fantastiko – shkencore, mundëson që kjo rrjedhë optimiste të fitojë formën e vet të plotë.

Pra, bëhet fjalë për dy pole të ndryshme të letërsisë postmoderniste, që përbëjnë çiftin gjithpërfshirës struktural të letërsisë, poli që merret me shtypjet në Tokë dhe ai tjetri, që e drejton shikimin drejt Qiellit, gjegjësisht që mëton t'i vë heronjtë në lëvizje, në aksion. Letërsia që drejton shikimin e saj drejt Qiellit, me vizionet e saj optimiste, i kundërvihet letërsisë që merret me presionet në Tokë, por vetëm të dyja së bashku përbëjnë çiftin strukturor të letërsisë postmoderniste, meqë njëra nuk do të mund të ekzistonte pa tjetrën.

Baza mitologjike është prezente edhe në modernizëm edhe në postmodernizëm. Modernia e hudh poshtë raportin e njëanshëm arsye mitologjike - krijim artistik dhe format mitologjike në begatinë e tërë raporteve të tyre, gati me bindje se vepra e sapokrijuar letrare do ta ndryshojë botën.

Baza mitologjike, si e tillë, është prezente edhe në letërsinë postmoderniste, me atë që krijuesi postmodern është me pak ambicioz, gjegjësisht me skeptik në vrojtimin e rolit të tij shoqëror, por nga ana tjetër është edhe më shumë i vetëdijshëm për lidhjet e formave mitologjike - letrare. Për krijuesin postmodern, vepra moderne letrare luan atë rol që luan rrëfimi mitologjik për krijuesit modern. Kështu, në veprat e tyre, letërsia dhe mitologjia bashkohen në një, kurse në themelet e modeleve, tani më të pranuar, përpiqen të krijojnë vepra të reja origjinale. *“E zënë në antinominë strukturale greke: të jetës dhe vdekjes, njerëzve dhe hyjnive, dashurisë dhe rrëfimeve, fantasia bashkëkohore letrare e vazhdon ecjen e saj ujrave nëntokësore jetësore të mitit dhe të veprave paraprake letrare, meqë çastet e tyre epifanike, me zbulimin e shkëndive të tyre, mundësojnë qëndresë të ardhshme edhe përkundër shtigjeve të parrugdalje spirale të historisë dhe nëndijes njerëzore”* (Filippi 1985: 212).

Krijuesit postmodernist e tejkalojnë parashikimin realist - modernistik mbi artin si fotografi të realitetit dhe artit si iluzion. Për Zhan Bodrijar-in, arti postmodernist krijon një hiper-realitet. E tillë është bota e simulacionit. Hiper-realiteti paraqet një realitet, që duket më real se vet[realiteti. Në veprat postmoderniste, shpesh, s'ka as fikcion e

as realitet, por hiper-realiteti është ai që i ndërpret të dyja. *"Të desimulosh, do të thotë të bëhesh se nuk e ke atë që e ke. Të simulosh, do të thotë të bëhesh sikur e ke atë që nuk e ke. E para në shpie drejt prezencës, e dyta drejt mungesës"* (Bodrijar 2001: 7). Duke studiuar fenomenin e simulacionit në artin bashkëkohor, Bodrijar ndalet, veçmas, në studimin e dëshirës së regjisorëve filmik[për të paraqitur jetën reale, nëpërmjet të artit filmik.

Rrafshi tematik

Modernia dhe postmodernia dallojnë edhe për nga temat e trajtuara. Kështu, sipas D. Fokema (Fokkema, *The Metamorphosis of Postmodernism*: . .), janë dy tema globale të postmodernizmit, që e dallojnë atë nga modernizmi: *fundi i narracioneve të mëdha dhe dominanta ontologjike e postmodernizmit*.

Temës së par[kujdes të posaçëm i kushton F. Liotar (Liotar 2007), duke u shprehur se në postmodernie nuk ka vend për ngjarje të mëdha. Ai e kupton modernien, si *"krizë të narracionit"*.

Për Çarls Rasell-in, postmodernizmi është *"Art i kritikës, pa porosi tjetër pos nevojës për të vënë përherë në dyshim. Ky është art i shqetësimeve, për një publik të definuar qartë, pos atij të prirë për dyshim dhe kërkim"* (Haçion 2004, 1 – 2: 36).

Postmodernia i kushton kujdes edhe kontekstit - si atij të lexuesit, ashtu edhe atij të shkrimtarit. Ajo rikontekstualizon si procesin prodhues (*autorin*), ashtu edhe atë receptues (*lexuesin*), ashtu siç rikontekstualizon edhe vetë *tekstin* brenda situatës së përgjithshme komunikuese, që përfshin kontekstet shoqërore, historike, kulturore etj.

Arti postmodern nuk e mohon individualen, por e *rivendos atë*. Ai nuk e mohon as kolektiven, sado që pranon se ajo shpesh përdoret për manipulime. Llojllojshmëria dhe paradoksalja janë ata që e tërheqin postmodernien. Postmodernia është e mbushur me ndjenjën e dyshimit.

Postmodernia, ashtu si edhe modernia, është art i kundërthënieve, të cilat i thekson aq shumë, saqë bëhen edhe veçori përcaktuese e sistemit të saj. Kundërthëniet dhe lëvizja drejt

antitotalitarizmit janë karakteristika të rëndësishme të artit postmodern.

Postmodernia, në asnjë formë, nuk është absolute, ajo është e vetëdijshme se është e pamundur të krijohet ndonjë hierarki ose sistem prioritetesh jetësore. Në botë ekzistojnë të gjitha llojet e rrethave dhe të sistemeve dhe të gjitha i krijojmë ne. Ata nuk ekzistojnë jashtë sistemeve të dhëna, janë konstruksione të njeriut në histori. Lokalja, e kufizuara, e kohëpaskohshmja, provizoria shpesh përcaktojnë *"të vërtetën"* postmoderne.

Perfundim

Si përfundim do të shtonim se për lidhjet mes postmodernies dhe modernies, ekzistojnë dy teori dominuese të të menduarit: *sipas së parës* postmodernia kuptohet si shkëputje e plotë nga modernia, pra si ndërprerje radikale; kurse *sipas së dytës* postmodernia kuptohet si vazhdimësi dhe intensifikim i karakteristikave të modernies. Veprat postmoderniste, shpesh, janë tekste të transformuara moderniste.

Është thënë shpesh se postmodernia krijon tekste të ndërlikuara letrare, që ju dedikohen kryesisht lexuesve akademikë, të cilët janë të interesuar për tekste të tilla. Por, nga ana tjetër, është fakt se një numër i mirë i veprave postmoderniste janë në mesin e veprave më të lexuara dhe më të shitura në botë. Mendohet se pikërisht aftësia që të gërshetojë format e larta dhe të ulta të artit, madje shpesh nëpërmjet të ironizimeve të tyre, e mundëson një gjë të tillë. Kështu, postmodernizmi arrin të jetë akademik i popullarizuar edhe elitist i pranueshëm dhe i perceptueshëm. Teknikat e rivendosjes dhe pastaj rrënimit të konvencave të njërit edhe të llojit tjetër të artit, paraqesin një mënyrë, nëpërmjet të cilës postmodernizmi arrin status të tillë.

Bibliografia

- BART, Rolan (1979), *Knjizevnost, mitologjia, semiologjia*, Nolit, Beograd.
 BODRIJAR, Zhan (2001), *Simulakrum i simulacija*, Magor, Shkup.

- DOUWE, Fokkema (1996), *The Metamorphosis of Postmodernism: The European Reception of an Amerikan Concept: Postmodernism in Literature and Kulture of Central and Eastern Europe*, Katovicë.
- FILIPPI, Zhivan (1985), *Sedam antropoloskih struktra u postmodernoj knjizhevnosti*, August Cezares, Zagreb.
- HAÇION, Linda (2004), Intertekstualiteti, parodia dhe diskurset e historisë: *Fjala* (prill-maj), Prishtinë.
- HAÇION, Linda (2004), Përkufizimi i postmodernës: rrjedhimet paradoksale të modernizmit: *Jeta e re*, nr. 1-2 (janar-prill), Prishtinë.
- HAÇION, Linda (1996), *Poetika postmoderne*, Svetovi, Novi Sad.
- KRISTEVA, Julia (1996), Intertextuality and Literary Interpretation: *Julia Kristeva interviews*, ed. R. K Guberman, Columbia University Press, New York.
- KRISTEVA, Julija (1989), *Moci uzasa*, Naprijed, Zagreb.
- LANDOW, P. George (1992), *Histori of the Concept of Hypertext (The Definition of Hypertext)*, The John Hopniks Univer sity Press, New York.
- LIOTAR, Zhan-Francoa (2007), *Postmoderna sostojba*, Az-buki, Shkup.
- Todorov, Cvetan, *Poetika*, Na{a kniga, Shkup, 1991.
- WAUG, Patricia (1984), *Metafiction (The Theory and Practise of Self-Conscious Fiction*, Routledge, London and New York
- VO, Patrisha (2007), Shto e meta-fikcija i zoshto za nea velat uzhasni neshta: *Sudbinata na zna]enjeto* (perg. Venko Andonovski), Kultura, Shkup.
- ZHENET, Zherar (1985), Retorika i obrazovanje: *Figure*, Kultura, Beograd.
- ZHENET, Zherar (2003), Palimsest: *Teorija na intertekstualnosta* (krestomaci e përgatitur nga Kata Qullafkova), Kultura, Shkup..